



DIFFERENT & EQUAL
TE NDRYSHEM & TE BARABARTE

Raport Vjetor

PËRMBAJTJA

- Përfituesit/et e programit.....3
 - Profili i rasteve viktime / viktime të mundshme trafikimi.....3
- Programe të D&E të zbatuara gjatë Janar – Dhjetor 2019.....7

MBROJTJA DHE RIINTEGRIMI

- Programi i riintegrit për viktime /viktime të mundshme të trafikimit në Shqipëri.....7
- Asistencë direkte për vajza, gra dhe meshkuj viktime të trafikimit /viktimeve të mundshme të trafikimit.....7
- Kontributi në kthimin e asistuar të viktimeve të trafikimit /viktimeve të mundshme të trafikimit.....7
- Rritja e përpjekjeve për identifikimin e viktimeve /viktimeve të mundshme të trafikimit..... 13
- Programi i asistencës ligjore për viktime bazuar në përjasjen me në qendër viktime; shërbimi ligjor falas..... 14
- Mbështetje për fëmijët e viktimeve të trafikimit dhe dhunës në familje për të qënë të sigurt nga abuzimi dhe neglizhimi..... 15
- Bashkëpunim ndërmjet OShC-ve dhe grupeve të ish-viktimeve të trafikimit dhe dhunës në familje për fuqizimin ekonomik të viktimeve.....17

PARANDALIMI

- Përfshirja e viktimeve të trafikimit dhe dhunës seksuale në adresimin e problemeve që kanë rëndësi për ta – “EDHE ZËRAT TANË”..... 19
- Aktivitete ndërgjegjësimi mbi trafikimin në persona.....22
- Aktivitete ndërgjegjësimi për të drejtat e viktimeve të veprave penale.....24
- “Mbështetje për zhvillimin e kapaciteteve të njërive për mbrojtjen e fëmijëve në Bashkitë e përzgjedhura për të adresuar trafikimin e fëmijëve dhe shfrytëzimin për punë”25

BASHKËRENDIMI


- Koordinime me aktorë të tjerë kundër trafikimit.....26
- Rritje e kapaciteteve të profesionistëve.....26
- Trajnime dhe prezantime të ofruara nga D&E.....27

PUBLIKIME D&E


- Publikime.....28

1.Përfituesit e programit


Gjatë periudhes Janar – Dhjetor 2019 janë asistuar në total në programin riintegrues të organizatës **105 raste dhe 130 fëmijë të tyre.**



PROFILI I RASTEVE VIKTIMA / VIKTIMA TË MUNDSHME TRAFIKIMI



Niveli Arsimor i rasteve të reja



Statusi



26 Beqar/e




3 I/e martuar



2 I/e divorcuar



2 Bashkëjetesë



Vendi ku kanë qenë trafikuar


Vendi ku janë trafikuar	Total
Shqipëri	56
Kosovë	2
Itali	1
Greqi	1
Gjermani	5
Angli	2
Zvicër	1
Serbi	1
Danimarkë	1
Greqi, Shqipëri	3
Kosovë, Shqipëri	3
Gjermani, Shqipëri	1

Forma e shfrytëzimit	Total
Shfrytëzim seksual	49
Punë e detyruar	3
Martesë e detyruar	2
Lypje	3
Aktivitet kriminal	7
Shfrytëzim seksual & punë e detyruar	5
Shfrytëzim seksual & lypje	3
Shfrytëzim seksual & aktivitet kriminal	1
Lypje & punë e detyruar	1
Lypje & aktivitet kriminal	2
Martese e detyruar / shfrytëzim seksual	1

Burimi i referimit për rastet e reja të asistuara gjatë Janar – Dhjetor 2019:


Burimet e referimeve	Nr. i rasteve
<i>Komisariati i Policisë nr. 4</i>	1
<i>Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë</i>	1
<i>Drejtoria Vendore e Policisë Durrës</i>	1
<i>NJMF / DRSHSSH Korçë</i>	1
<i>Bashkia Tirane (Qendra Komunitare)</i>	1
<i>Bashkia Kukës (NJMF)</i>	1
<i>Shërbimi Social Shtetëror</i>	1
<i>NJMF Thumanë</i>	1
<i>Njesia Lëvizëse D&E (në bashkëpunim me DVP, NJMF 1, NJMF Synej, NJMF 11, NJMF Kashar, NJMF 5)</i>	9
<i>QKPVT</i>	4
<i>ICITAP / Ambasada Amerikane</i>	1
<i>Mary Ēard Loreto</i>	1
<i>SOLĒODI Gjermani</i>	4
<i>Global Care</i>	1
<i>Streha LGBT</i>	1
<i>Spitali Psikiatrik Elbasan</i>	1
<i>Krahët e Shqiponjës</i>	1
<i>Linja e Keshillimit per Gra dhe Vajza</i>	1
<i>IOM Tirana /Danimarke</i>	1
TOTAL	33

Profili i Rasteve Viktima Të Abuzimit dhe Dhunës Në Familje



Statusi





- ▶ I lartë -1 rast
- ▶ E mesme-3 raste
- ▶ E mesme /e papërfunduar-2 raste
- ▶ 8-9 vjeçar-13 raste
- ▶ Pa arsim- 1 rast

Niveli Arsimor i rasteve te reja

Burimi i referimit për rastet e reja të asistuar gjatë Janar – Dhjetor 2019:

Burimet e referimeve	Nr. i rasteve
Qendra Kombëtare e Trajtimit Për Viktimat E Dhunës Në Familje	3
Tjetër Vizion	1
Bashkia e Tiranës	1
Solëodi Gjermani	3
Ministria e Shëndetësisë	1
Qendra LILIUM	2
Organizatë Suedeze	1
Avokati i Popullit	1
Komisariati i Policisë – Kurbin	1
IOM	1
Komisariati i Policisë nr.1 Tiranë	1
Vetëreferim	3
Totali	19


PROGRAME TË D&E TË ZBATURA GJATË JANAR – DHJETOR 2019

MBROJTJA DHE RIINTEGRIMI

Programi i riintegrit për viktimat /viktimat e mundshme të trafikimit në Shqipëri

Donatorë: Pro Victims; UNOHCHR; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përmes Qarkut Tiranë dhe Bashkisë Tiranë; Ambasada Amerikane

- **Asistencë direkte për vajza, gra dhe meshkuj viktimë të trafikimit /viktimave të mundshme të trafikimit**



Tre fazat ku D&E ka ofruar asistencë riintegruese për viktimat e trafikimit

Një paketë e plotë shërbimesh riintegruese është ofruar për përfituesit e programit të riintegrit të D&E:

- ▶ **Strehim**
- ▶ **Siguri dhe plan ri-integrimit;**
- ▶ **Asistencë e menjëhershme mjekësore;**
- ▶ **Negocim / ndërmjetësim me familjen;**
- ▶ **Vlerësime dhe këshillime psikologjike;**
- ▶ **Mbështetje dhe asistencë ligjore;**
- ▶ **Asistencë për rregjistrim/ vazhdimësinë e sistemit shkollor;**
- ▶ **Trajnime profesionale;**
- ▶ **Aktivitete sociale;**
- ▶ **Mentorim;**
- ▶ **Këshillim dhe ndihmë për punësim;**
- ▶ **Mbështetje financiare për strehim;**
- ▶ **Informacion mbi shërbimet që ekzistojnë në komunitet si dhe kontaktet e nevojshme/ harta e shërbimeve;**
- ▶ **Programe pune që krijojnë të ardhura;**
- ▶ **Asistencë dhe mbështetje për fëmijët e viktimave të trafikimit;**
- ▶ **Monitorim dhe ndjekja e mëpasshme e përfituesve të programit.**


Përveç asistencës direkte me përfitueset, D&E ka punuar e mbështetur dhe familjen e viktimës- p.sh fëmijët e përfitueses, asistencë për prindin e një minoreni që të gjejë punë, këshillim familjar, etj.

- **Shërbimet shëndetësore**



Mjeku i D&E ka bërë vlerësimin mjekësor të rasteve të reja të hyra në program dhe gjithashtu ka adresuar dhe trajtuar nevojat mjekësore të të gjithë përfituesve të programit të riintegritit, për përfitueset që janë të akomoduar në qendrën e riintegritit por edhe për ato të cilat janë në fazën e dytë të programit.

Për çdo rast të ri të hyrë në program janë bërë analizat rutinë (gjak komplet, urinë dhe ekzaminime për SST).



Gjatë vitit 2019 problemet shëndetësore që kanë pasur përfitueset dhe fëmijët e tyre kanë qënë:


Sëmundja	Nr. i rasteve	Nr. i fëmijëve
Probleme gastro-intesinale	1	1
Probleme dermatologjike	10	3
ORL	1	6
Probleme alergjike	2	2
Probleme gjinekologjike	7	
Anemi	2	1
Probleme dentare	10	
Okulist	2	
Djegje plastike		
Probleme reumatizmale	1	
Ortopedi-Traumatologji	4	
Colia abdominal dhe renale		
Probleme infektive	5	6
Infeksionet urinare	6	

Janë testuar për sëmundje seksualisht të transmetueshme 9 përfituese, prej të cilave 2 kanë rezultuar pozitive. Po 9 përfituese janë testuar për HIV/ AIDS dhe kanë rezultuar negative.

Probleme të shëndetit mendor

11 përfitues me probleme të shëndetit mendor janë ndjekur rregullisht nga psikiatri duke marrë trajtimin e duhur në vazhdimësi.

Janë hospitalizuar në QSUT dy raste, përkatësisht në Shërbimin e Psikiatrisë për adultët dhe Shërbimin e Psikiatrisë për fëmijët dhe adoloshentët përkatësisht me diagnozat çrregullim personaliteti borderline dhe PTSD me tentative suicidale.



Janë pajisur me karta shëndeti 13 përfitues të rinj të referuar në programin e D&E dhe është lehtësuar rinovimi i 7 kartave të shëndetit të përfituesve të mëparshëm për t'ju mundësuar përfitimin e një sërë shërbimeve shëndetësore falas.

D&E ka bashkëpunuar me një sërë institucionesh publike dhe jopublike për t'ju ofruar përfituesve shërbime të ndryshme shëndetësore të tilla si: *Albanian University - Dega Stomatologji*, nëpërmjet të cilit janë siguruar shërbime dentare falas për përfitueset e programit; Poliklinika Nr.9; Insituti i Shëndetit Publik; Insituti i Higjenes; Poliklinika Dentare "Ufo"; Spitali Obstetrik Gjinekologjik "Koco Glozheni" dhe "Mbretëresha Geraldine"; Urgjenca Polivalente e QSUT; Urgjenca Pediatrike.

- **Asistenca psiko-sociale**

Këshillimi psikologjik dhe psiko-social, terapia e artit, terapia okupacionale, teknikat e relaksimit janë aktivitetet e organizuara në kuadër të asistencës psiko-sociale. Të gjitha këto aktivitete synojnë mirëqenien psikologjike të përfituesve.

	Këshillim individual psikologjik ofruar nga psikologu	Këshillim individual psiko-social ofruar nga menaxherët e rasteve	Terapi Arti në grup	Punë krijuese dhe terapi okupacionale
Nr. i sesioneve	503	3644	36	33



Disa nga teknikat e përdorura gjatë seancave në grup të terapisë së artit kanë qenë: Ajsberg, Identifikimi i Ngjyrës, Vizatimi i Lirë, Si ndihem, Vendi im në këtë botë, Vizatoni me dorën tuaj, Emocionet dhe unë, Pemë me të dashurit, Kujtimet e fëmijërisë, Pikturë në kanavacë, Mozaik ngjyrash, auto-portret dhe identitet etj.

- Edukimi dhe shkollimi

Nivel Arsimi	Nr. i përfitueseve VT/VMT	Nr. i fëmijëve të VT/VMT
Shkollë 9 – vjeçare	12	10
Shkollë e Mesme	12	
Universitet	1	0
Total	25	10

- ↔ Një vlerësim për përcaktimin e nivelit arsimor të çdo përfitueseje në program realizohet nga mësuesja e D&E dhe në bazë të këtij vlerësimi zhvillohet një plan edukativo – mësimor si pjesë e planit të riintegritimit të çdo përfitueseje.
- ↔ Gjatë kësaj periudhe 25 përfitues/e dhe 10 fëmijë të tyre janë mbështetur dhe kanë ndjekur shkollën në nivele të ndryshme.

Rritja e përpjekjeve për fuqizimin ekonomik të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit

► Trajtime për punësim / kurse profesionale:

- ↔ 30 përfitues/e kanë ndjekur kurse profesionale.
- ↔ Disa përfitues kanë ndjekur më shumë se një kurs, bazuar në aftësitë dhe dëshirat individuale.

Nr	Lloji i Kurseve	Ofruar	Nr. i rasteve
1.	Kurs kompjuteri	Qendra e Edukimit D&E	15
2.	Parukeri /Estetikë	Qendër e formimit profesional	6
3.	Kurs kuzhine	Qendër e formimit profesional	1
4.	Rrobaqepsi	Shkollë profesionale	1
5.	Anglisht	Qendra e Edukimit D&E Qendër e gjuhëve të huaja	9 1
6.	Italisht	Qendra e Edukimit D&E Qendër e formimit profesional	6 1
7.	Gjermanisht	Qendër e gjuhëve të huaja	2
8.	Kurs kitare	Qendra e Edukimit D&E	9
9.	Kurs gatimi per pica	Kompani Private Biznesi	3
10.	Bebisiter	Qendër e formimit profesional	1
11.	Kurs piktore	Qendra Tirana Art	1

Këshillim për punësim dhe punësimi

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor, 36 përfitues/e të D&E kanë qënë në marrëdhënie pune, të punësuar si: *ndihmëse kuzhinier/e në restorante dhe pasticeri, banakiere, kamarier/e, pjatatarëse në restorante, operator në Qendra Interneti and Call Center, arreduese, shitëse ne furrë buke, sanitare, shpërndarës ushqimi*, etj.

D&E ka mbështetur përfituesit e programit në përpjekjet e tyre për të hyrë në tregun formal të punës. Stafi i D&E orienton në mënyrë të vazhdueshme përfitueset/it të zgjedhin profesione të kërkuara në tregun e punës, duke u përshtatur natyrisht në çdo rast me aftësitë e tyre personale. D&E ka bashkëpunuar ngushtë me Shërbimin Kombëtar të Punësimit/Drejtorinë Rajonale të Punësimit dhe kompanitë private gjatë kësaj periudhe.

Programe internship-i me kompanitë e biznesit

Gjatë vitit 2019, 2 përfituese kanë qënë të përfshira në programin e internshipit, duke punuar si ndihmës kuzhinierë në restorante. Një marrëveshje bashkëpunimi është nënshkruar me kompaninë e biznesit, për të përcaktuar detyrimet dhe përgjegjësitë e secilës palë.

Një përfituese është mbështetur me blerjen e materialeve artizanale për përgatitjen e punëve të ndryshme me dorë dhe është mbështetur nga D&E për ti shitur këto prodhime.

Rritja e aksesit në drejtësi për viktimat e trafikimit

D&E ka ofruar asistencë ligjore për të gjithë përfituesit/et në program përmes avokatit të D&E.

Asistenca ligjore ka konsistuar kryesisht në:

- *Informimin dhe riinformimin e gjithë përfituesve të programit mbi të drejtat e tyre*
- *Shoqërimi i përfituesve gjatë dhënies së deklarimeve në polici, prokurori.*
- *Përfaqësimin dhe ndjekjen e të gjitha çështjeve penale dhe civile të përfituesve.*
- *Informimi i përfituesve në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e çështjeve të tyre*
- *Mbështetje për përfituesit e huaj për të aplikuar për lejeqëndrimi, dokumenta identifikimi në ambasadat respektive etj.*

15 raste kanë bashkëpunuar me Strukturat e Zbatimit të Ligjit duke denoncuar trafikantët, 9 prej tyre janë raste të reja që kanë hyrë në program gjatë këtij viti.

Avokati i D&E ka organizuar sesione me përfituesit duke diskutuar tema të ndryshme ligjore si:

- *Shërbimet Sociale në Bashki*
- *Ligji për të Dhënat Personale*
- *E drejta e pronësisë dhe pozita e grave në lidhje me pronën*
- *Ligji për të Huajt*
- *Ligji për të drejtën e informimit*
- *Njohuri mbi institucionet publike në Shqipëri*
- *Të drejtat e fëmijëve*
- *Lëvizja e lirë e qytetarëve në zonën Shengen*
- *Të drejtat dhe detyrimet e të rriturve*
- *Ligji për Sigurimet Shoqërore*
- *Ligji "Për Masat kundër Dhunës në Familje"*
- *Barazia gjinore dhe diskriminimi*
- *Sistemi gjyqësor në Shqipëri*
- *Aksesi në drejtësi*

Asistenca Sociale

Një sërë aktivitesh social – kulturore dhe aktivitete për rritjen e aftësive për jetën janë organizuar çdo javë për të gjithë përfituesit e programit të D&E. Aktivitete janë organizuar brenda dhe jashtë Qendrës së Riintegritimit (për përfitueset e akomoduar në qendër). Aktivitetet e natyrës edukative janë organizuar në ambjentet e Qendrës së Edukimit të D&E nën supervizionin e instruktorëve dhe trajnerëve, ndërkohë që aktivitetet e organizuara në Klubin e Kauzës Sociale kanë ndihmuar përfitueset të rrisin aftësitë për veten, duke u socializuar dhe duke kaluar një kohë miqësore me njëra –tjetrën.



Lojra të lira në natyrë



Art Terapi



Lojra argëtuese



Diskutim në grup



Vizitë në Kishën e Laçit



Vizitë në Liaenin e Bleshit



Joga



Kurs kompjuteri



Klubi i Artit

Të gjitha përfitueset e akomoduar në Qendrën e Riintegrimit të D&E kanë marrë pjesë në programin **"Fuqizim nëpërmjet Vetëmbrojtjes"** organizuar nga **Aikido Albania**. Qëllimi i programit ishte të ndihmonte pjesëmarrësit për të zhvilluar komunikimin dhe rritur vetbesimin ndërmjet aktiviteteve për aftësi verbale, emocionale, psikologjike dhe fizike. Ndërkohë që 3 përfituese kanë ndjekur një kurs 3 mujor vetëmbrojtje.



Programi i mentorimit

Unë jam shumë e lumtur që kam një mentore. Ne dalim bashkë, bisedojmë, mësojmë nga njëra –tjetra.

A. përfituese

Gjatë vitit 2019 tre mentorë kanë ofruar mentorim për 16 përfitues/e të programit të D&E.

Mentorët kanë ofruar mbështetje individuale në bazë javore për përfitueset që kanë mentoruar, në përputhje me nevojat e tyre dhe duke ndjekur aktivitetet e dakortësuara bashkarisht. D&E ka ofruar në mënyrë të vazhdueshme supervizim individual dhe në grup për mentorët, në mënyrë që procesi i mentorimit të jetë sa më efektiv për të dyja palët.

Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe midis mentorëve dhe përfituesve kanë qënë:

- ✓ Të planifikuara dhe realizuara sipas interesave dhe dëshirave të përfitueseve
- ✓ të fokusura në edukimin dhe informimin e përfitueseve
- ✓ të fokusura për të rritur aftësitë për jetën dhe për të adaptuar një stil jetesë të shëndetshme

Monitorimi dhe ndjekja e mëpasshme e përfitueseve të programit

Përfitueset e fazës së dytë e të tretë të programit të D&E janë mbështetur me të gjitha shërbimet në komunitet bazuar në nevojat e tyre.

Progresi i riintegrit të rasteve është monitoruar nga menaxherët e rasteve në baza ditore, javore dhe mujore; monitorimi ditor bëhet nga menaxherët e rasteve gjatë turnit të punës. Monitorimi javor dhe mujor realizohet në baza të rregullta nga menaxheri i rasteve dhe koordinatori i fuqizimit ekonomik.

Gjatë vitit 2019, 3113 sesione këshillimi janë ofruar për përfituesit e fazës së dytë dhe të tretë të programit nga menaxherët e rasteve.

Ndihmë financiare dhe afatgjatë

35 raste dhe 18 fëmijë të tyre janë mbështetur dhe asistuar financiarisht për qiranë e apartamentit me qera; 31 raste dhe 3 fëmijë të tyre janë ndihmuar në familjet e tyre të orgjinës dhe 2 raste dhe 3 fëmijë janë asistuar në vende të tjera alternative.

D&E ka vazhduar të ofrojë mbështetje financiare për qiranë e apartamentit për përfituesit e fazës së dytë të programit të riintegrit.

Informacion mbi shërbimet në komunitet

Stafi i D&E ofron mbështetje të vazhdueshme për rastet duke u ofruar atyre informacionin e nevojshëm për shërbimet ekzistuese në komunitet.

Një hartë të shërbimeve në komunitet u shpërndahet përfituesve, të cilët në disa raste shoqërohen drejtpërdrejt nga menaxherët e tyre të rastit për të njohur drejtpërdrejt këto lloj shërbimesh.

Përfituesit informohen për të drejtën e tyre për të përfituar ndihmë ekonomike si VoT dhe ata mbështeten në përpilimin e dokumenteve të nevojshme.

○ Kontributi në kthimin e asistuar të viktimave / viktimave të mundshme trafikimit

Kthimi i viktimave të huaja në vendin e tyre të origjinës:

Gjatë kësaj periudhe **D&E ka asistuar 4 raste të huaja** të cilat vijnë nga vende të ndryshme.

1 rast është kthyer në vendin e tij të origjinës.

Kthimi i viktimave shqiptare të identifikuar jashtë vendit:

7 raste shqiptare të identifikuar jashtë vendit, janë rikthyer në Shqipëri. Rastet kanë ardhur nga vende të ndryshme si: Gjermania, Danimarka dhe Kosova. Sapo kanë hyrë në program, për secilin prej rasteve është ofruar një paketë e plotë e shërbimeve të riintegritimit bazuar dhe në nevojat e tyre.

II. Rritja e përpjektjeve për identifikimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit nëpërmjet Njesisë Lëvizëse

Në kuadër të projektit “Të rrisim identifikimin proaktiv të viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit në nivel lokal” mbështetur financiarisht nga Ambasada Amerikane në Tiranë është bërë i mundur aktivizimi i Njesisë Lëvizëse të D&E. Falë këtij aktivizimi dhe rritjes së bashkëpunimit me Antarët e Mekanizmit Kombëtar të Referimit është rritur identifikimi i VT/ VMT dhe referimi i tyre për të marrë shërbime dhe asistencë direkte në nivel lokal.



“Kur dëgjon histori të vajzave të trafikuar të duken si të pabesueshme, si jo reale. Pasi ndoqa trajnimin tuaj kuptova që ky fenomen është kaç afër nesh dhe vështiresitë që hasin viktimat e trafikimit janë shumë të mëdha. Sa më shumë informacion të kenë njerëzit për këtë fenomen aq më pak do guxojnë ti gjykojnë këto vajza.”

Mjeke, pjesëmarrëse në trajnimin me personel mjekësor të Institucioneve të kujdesit shëndetësor, 4 Shkurt 2019




Në kuadër të zbatimit të këtij projekti organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave hartuan “Standartet e shërbimit të Njesisë Lëvizëse për identifikimin dhe referimin e viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit”.

Ky dokument është produkt i konsultimit dhe rishikimit me aktorë të ndryshëm me eksperiencë dhe të interesuar seriozisht për identifikimin proaktiv të viktimave të trafikimit në Shqipëri përfshirë aktorët e parashikuar në Planin e Veprimit, si: Drejtoria e Antitrafikut dhe Migracionit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Koalicioni i Strehëzave Anti – Trafik, Shërbimet Sociale të Bashkisë Tiranë dhe Autoriteti Përgjegjës.

Standartet janë në vetvete deklarata qëllimesh që duhet të arrihen. Ato janë hartuar për t'i ardhur në ndihmë dhe për të mbrojtur punonjësit e angazhuar me identifikimin fillestar, për të rritur dhe mbajtur lart efektivitetin dhe cilësinë e punës së tyre.

Procesi i hartimit të këtyre standardeve dhe forma me të cilën vijnë, i bëjnë ato të gatshme të integrohen menjëherë në dokumenta dhe procese që planifikohen të zhvillojnë më tej sistemin antitrafik.



III. Programi i asistencës ligjore për viktimat bazuar në përqasjen me në qendër viktimën; shërbimi ligjor falas

Projekti **“Drejtësia është histori e vërtetë kur në plan të parë janë viktimat”** zbatuar nga organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” dhe mbështetur financiarisht nga Save the Children në partneritet me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara, me fonde nga Bashkimi Evropian ka vazhduar të ndihmojë dhe mbrojë viktimat e krimit, në mënyrë të veçantë viktimat e trafikimit nëpërmjet ofrimit të ndihmës direkte dhe ndihmës ligjore falas; nëpërmjet rritjes së kapacitetit të institucioneve të zbatimit të ligjit; rritjes së informacionit për të drejtat e viktimave dhe aksesit në drejtësi; dhe advokimit për të përmirësuar legjislacionin.

Gjatë vitit 2019 aktivitetet kryesore të projektit kanë qënë:



Në bashkëpunim me Zyrën e Koorindatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave janë realizuar 2 trajnime me temë “Të drejtat e viktimave të veprës penale”:



Gjatë muajit prill 2019 pas një takimi të zhvilluar me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore filloi puna për ngritjen e një grupi ad-hoc për kryerjen e një analize dhe vlerësimi të thelluar mbi nevojën për një ligj të veçantë me fokus mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore – VKK Nr. 770, datë 26.12.2018 (Kapitulli për Ndjekjen Penale, aktiviteti 1. (a).6.

Puna e grupit ad-hoc u finalizua me përgatitjen e Raportit Studimor mbi Nevojën e Hartimit të një ligji të veçantë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit në Shqipëri.



Duke reflektuar rekomandimet dhe sugjerimet grupit të punës, si dhe komentet e mbledhura gjatë hartimit të raportit studimor për nevojën e një ligji të veçantë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit do të veçonim këto përfundime si avantazhe të ligjit:

- Shërben si ligj kuadër në të cilin integrohen dhe plotësohen të gjitha masat për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, duke zgjidhur më së miri edhe mungesën e referimit të akteve të ndryshme që rregullojnë aspekte të veçanta të fushës antitrafikim;
- Shërben si një instrument për të garantuar një mbrojtje efektive me një qasje pro-viktimave dhe përcakton qartë strukturat përgjegjëse dhe mekanizmat për mbrojtjen e viktimave të trafikimit;
- Shërben për krijimin e një skeme shtetërore kompensimi për viktimat e trafikimit dhe plotësimin e mangësive ligjore për kompensimin nëpërmjet procesit gjyqësor;
- Nxit dhe përmirëson bashkëpunimin e viktimave të trafikimit me strukturat e zbatimit të ligjit për të denoncuar trafikantët;
- Përmirëson procesin e identifikimit formal të viktimave të trafikimit, duke nxitur identifikimin pro-aktiv dhe interesin e viktimave për vetë-identifikim;
- Zgjidh edhe situatën e përcaktimit të statusit të viktimave të trafikimit, duke parashikuar një mekanizëm ankimi në nivel administrativ dhe në rruatë ajrore.

Në kuadër të projektit rajonal **"Balkans Act Now - BAN III "**, D&E ka zbatuar projektin **"Aplikimi i një qasje pro-viktimave mënyra më e mirë për zbatimin e ligjit"**, **mbështetur financiarisht nga** Bashkimi Evropian nëpërmjet Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) në Shqipëri.

Projekti kishte për qëllim sigurimin e një mbrojtje efektive për viktimat e trafikimit, për të vënë viktimat dhe interesat e tyre në qendër të vëmendjes të veprimeve të të gjithë strukturave të zbatimit të ligjit.

Ndërhyrja konsistoi në monitorimin e disa rasteve të trafikimit që nga faza e parë identifikimit dhe referimit, duke përfshirë hetimin dhe gjykimin, si dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit.

Nëpërmjet monitorimit të 10 rasteve të përzgjedhura u bë një analizë e zbatimit të ligjit që rregullon mbrojtjen e viktimave të trafikimit si dhe rolin që kanë luajtur institucionet përgjegjëse në çdo fazë të procesit, duke filluar nga identifikimi, referimi dhe deri në riintegrimin e viktimave të trafikimit në shoqërinë shqiptare.

Mbështetje për fëmijët e viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje për të qënë të sigurt nga abuzimi dhe neglizhimi

Nëpërmjet këtij projekti ofrohet përkujdesje profesionale në alternativat e kujdesit "Shtëpia e Gjyshes/ Shtëpia Tjetër" për fëmijët e nënave viktimat trafikimi dhe viktimat të dhunës në familje, duke ju ofruar një mjedis të qetë dhe të sigurt ndërkohë që nënat e tyre janë në punë. Shërbimi ofrohet për fëmijët nga e hëna në të shtunë, pas orarit zyrtar të funksionimit të çerdheve dhe kopshteve publike.

Gjatë vitit 2019 në kuadër të këtij projekti është bërë i mundur vazhdimi i funksionimit të tre alternativave të përkujdesit të fëmijëve, dy në Tiranë dhe një në Elbasan, si edhe hapjen e 2 alternativave të reja të përkujdesit të fëmijëve në Bashkinë Shkodër dhe në Kamzë.



Në total 69 fëmijë kanë frekuentuar pesë alternativat e përkujdesit të fëmijëve të D&E.



dfg

Në muajin Shkurt 2019, D&E hapi në Bathore, Bashkia Kamëz, një alternativë të re përkujdesi për fëmijë. Alternativa u hap në bashkëpunim me Fondacionin "Global Care Albania" dhe Bashkinë Kamëz.




Në muajin Maj 2019, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër D&E hapi alternativën e re të përkujdesit të fëmijëve në këtë bashki.

"Unë nuk kisha askënd që të kujdesej për fëmijët e mi dhe prandaj e kisha të pamundur që të gjeja një punë. Tani që fëmijët frekuentojnë qendrën tuaj, unë po punoj e qetë nga e hëna në të shtunë dhe gjendja ime ekonomike po përmirësohet."

Nëna e dy fëmijëve që frekuentojnë Alternativën e Kujdesit Shkozë

"Dikur vajza ime ishte shumë e ndrojtur dhe nuk fliste, tani që frekuenton "Shtëpinë e Gjyshes" ajo ka filluar të flasë dhe bashkëveprojë me fëmijët e tjerë. Jam shumë e lumtur kur e shoh atë që çdo ditë mezi pret që të vijë këtu. Une tani punoj e qetë dhe ndihem shume mirë."*Nëna e një fëmije që frekuenton Alternativën e Kujdesit Shkodër*



Gjatë këtij viti, në kuadër të projektit u përgatit dhe u botua Modeli "Shtëpia e Gjyshes ose Shtëpia Tjetër", produkt i eksperiencës së profesionistëve, edukatorëve dhe stafit të organizatës 'Të Ndryshëm & Të Barabartë' në krijimin dhe aplikimin e modelit të një qendre ditore për të ndihmuar në kujdesin dhe rritjen e fëmijëve të viktimave të dhunës dhe trafikimit.

Në hartimin e këtij modeli është marrë gjithashtu në konsideratë legjislacioni aktual që rregullon arsimin, sigurinë, kujdesin shoqëror dhe mbrojtjen e fëmijëve.



Trajnime me punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve

Gjatë këtij viti, D&E në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve zhvilloi 2 ditë trajnime me Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve nga e gjithë Shqipëria. Trajnimi me temë **“Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve për Fëmijët e Viktimave të Trafikimit dhe të Dhunës në Familje”** u zhvillua në datat 13 & 14 Qershor 2019.

Trajnimi dha njohuri mbi kontekstin ligjor lidhur me trafikimin dhe dhunën në familje, efektet e dhunës dhe trafikimit tek nënat viktimat dhe fëmijët e tyre, shërbimet ekzistuese për viktimat dhe familjet, menaxhimi i rasteve dhe matja e efektivitetit të shërbimeve të dhëna për nënat dhe fëmijët etj.


54 pjesëmarrës morrën pjesë në trajnim.

Bashkëpunim ndërmjet OShC-ve dhe grupeve të ish-viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje për fuqizimin ekonomik të viktimave

Ky është vitit i dytë i zbatimit të projektit **“Bashkëpunim ndërmjet OShC-ve dhe grupeve të ish-viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje për fuqizimin ekonomik të viktimave”** mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian – si pjesë e programit për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe Medias 2016 -2017 dhe zbatuar nga organizata **“Të Ndryshëm & Të Barabartë”** në parteritet me Qendrën për Familjen dhe Fëmijën (KMOP) në Greqi.

Projekti synon të fuqizojë organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri, në ofrimin e shërbimeve riintegruese për viktimat e trafikimit/ dhunës në familje dhe të arrijë një përfshirje sociale harmonike të ish-viktimave, kryesisht përmes rritjes së nivelit të tyre të punësimit.

Katër zonat ku zbatohet projekti janë:



Projekti
“Bashkëpunim ndërmjet OShC-ve dhe grupeve të ish-viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje për fuqizimin ekonomik të viktimave”

Thirrja për aplikime dhe të qendruarit e hapur për një periudhë afatgjatë, nga 18 shkurt 2019 deri më 17 maj 2019.

Falënderojmë të gjithë aplikuesit dhe të qendruarit për informacionet përfaqësues për hënësuar dhe projektuarit e aplikimit tuaj në dispozicionin tëfaqësuar internetit: www.kmop.org, www.difensioarabartat.org



Në kuadër të projektit në 19 Mars 2019 u lanca skema e subgranteve për organizatat e shoqërisë civile që punojnë në Tiranë, Kukës, Dibër dhe Sarandë. **Autoriteti kontraktues përgjegjës për skemën e subgranteve nga partnerët e projektit është Qendra për Familjen dhe Fëmijën (KMOP).** Një sesion informimi u organizua për aplikantët e mundshëm në 28 Mars 2019, për ti informuar për kriteret e përgjithshme dhe specifike të Skemës së Nën- Granteve, parimet e shkrimit të projekt propozimit, kriteret e vlerësimit të thirrjes etj.

Gjatë muajit Mars në të katër zonat e projektit janë realizuar takime me përfaqësues nga institucione të pushtetit lokal, organizatave të shoqërisë civile si edhe kompanie të biznesit. Takimet u zhvilluan përkatësisht në datat 6 Mars 2019 në Kukës, 13 Mars 2019 në Tiranë, 20 Mars 2019 në Sarandë dhe 29 Mars 2019 në Dibër me qëllim nxitjen e diskutimit mbi veprimet konkrete që mund të ndërmerren për të lobuar për ndryshime në sektorin e formimit profesional dhe procedurat e punësimit apo vetëpunësimit të viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje, sipas prioriteteve të identifikuara në **“Studimin mbi nevojat dhe mundësitë që ofron tregu lokal i punës për të mbështetur fuqizimin ekonomik të të mbijetuarave të trafikimit dhe dhunës në familje në Tiranë, Kukës, Dibër dhe Sarandë.”**



Në përputhje me një nga objektivat e projektit është punuar gjatë këtij viti për të rritur kapacitetin organizativ të Shoqatës Shqiptare të Vajzave dhe Grave (AAGW), për të përmirësuar profilin e saj institucional si edhe mbështetjen dhe shërbimet që mund të ofrojë për anëtarët e saj.

Në këtë kuadër janë zhvilluar një sërë aktivitete:



Workshope

Workshop 4 ditor me anëtarët e AAGW-së me pjesëmarrjen e 9 anëtarëve. Gjatë Workshopit u dha informacion mbi planifikimin strategjik; zhvillimin e projekteve; organizimin e burimeve njerëzore; punën në ekip; menaxhimin i programeve dhe projekteve; fushatat ndërgjegjëse, hartimin e "raporteve hije / alternative" dhe përdorimin e tyre për avokim etj.



Sesione trajnimi

20 sesione trajnimi me vajzat dhe gratë anëtare të AAGW. Ku gjatë këtyre sesioneve antaret e AAGW-së janë ndihmuar të kuptojnë më shumë mekanizmat e ekzistues në Shqipëri në mbështetje të viktimave të dhunës dhe trafikimit, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, janë prezantuar me konceptet e Lobimit dhe Advokacisë (në nivel bazik), cilësitë dhe vlerat e drejtësisë të një organizate, zgjedhjen e anëtarëve të bordit drejtues të organizatës etj.



Aktivitet ndërgjegjësues

Aktivitet ndërgjegjësues në liqenin e Tiranës në muajin Tetor anëtarët e AAGW, me në fokus rritjen e ndërgjegjësimit për dhunën në familje. Mesazhet e propozuara nga antaret e AAGW u përcollën te njerëz të grup moshave të ndryshme në mënyrë të thjeshtë (tullumbace me mesazhe, borshura të vogla informuese etj.).



Gjatë muajit Mars u realizua fushata ndërgjegjëse #METY, duke patur si qëllim të përconte mesazhin e duhur atyre që janë duke përjetuar dhunë që nuk mund dhe nuk duhet të heshtin më.

Fushata ndërgjegjëse #METY.

Fushata u zbatua gjatë muajit Mars 2019 paralelisht në të katër zonat e projektit, falë bashkëpunimit shumë të mirë të ngritur me organizatat partnere të këtyre zonave.

Marshimi i realizuar në datën 8 Mars, në të njëjën orë në 4 zonat e projektit. Slogani i marshimit ishte #METY TË NGREMË ZËRINI

Bashkëpunimi me Federatën Shqiptare të Futbollit në javën e 26 të kampionatit ku futbollistët dolën në fushë duke mbajtur në fytyrë mesazhin #METY.





Gjatë muajit Prill 2019 u realizuan trajnimi 3 ditor me temë “Modeli i mentorimit të të mbijetuarave të trafikimit ose dhunës në familje”. Qëllimi i trajnimit ishte të aftësonte të mbijetuarat e trafikimit ose dhunës në familje (tashmë të fuqizuara dhe të riintegruara) për të shërbyer si mentore për viktime të cilat kanë dalë rishtas nga situata e shfrytëzimit ose dhunës. **Pjesëmarrëse në trajnim ishin 9 të mbijetuarat trafikimi/ dhune.**



Ndërkohë ka vazhduar rregullisht funksionimi i Klubit të Kauzës Sociale në bazë të një plani javor dhe mujor, i dakortësuar me antarët e Klubit. Mesatarisht 30-35 përfituese dhe 10- 20 fëmijë të tyre kanë frekuentuar klubin cdo muaj gjatë këtij viti. Interes ka pasur frekuentimi jo vetëm i klubeve formale (Klubi i FILMIT, Klubi i Kujdesit për Vetën, Klubi i Kuzhinës, Klubi i Muzikës, Klubi i Artit, Klubi i Punëve të Dorës/ Rrobaqepsisë, Klubi i Librit) por edhe aktivitetet e tjera joformale.

Gjatë muajit Nëntor 2019 antarët e Klubit kanë punuar intensivisht për përgatitjen e produkteve të ndryshme të dorës për t’i ekspozuar në panairë të ndryshme që organizohen në Tiranë me rastin e festave të fundvitit.



Në datën 25 Qershor 2019 u bë shpallja e aplikantëve fitues të skemës së sub-granteve. 7 organizatat e shoqërisë civile të përzgjedhura filluan në Shtator 2019 të zbatojnë projektet e tyre, duke sjellë iniciativa inovative të fuqizimit ekonomik të viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje në të katër zonat ku zbatohet projekti.

Gjatë kësaj periudhe dy trajnime janë ofruar për përfaqësuesit e organizatave fituese të skemës së sub-granteve	Trajnimi i parë u fokusua kryesisht në njohjen e detyrimeve në lidhje me pjesën e raportimit financiar dhe narrativ, sipas kërkesave të Bashkimit Evropian.	Ndërsa trajnimi i dytë u fokusua në fuqizimin dhe rritjen e kapaciteteve advokuese të organizatave sub-grantuese.
---	---	---



PARANDALIMI

1. Programi i përfshirjes së viktimave të dhunës seksuale në adresimin e problemeve që kanë rëndësi për ta – “EDHE ZËRAT TANË”

Ky projekt koordinohet nga Qendra Ndërkombëtare e Kërkimit për shfrytëzimin seksual të fëmijëve, dhunën dhe trafikimin në Universitetin Bedfordshire në Angli dhe mbështetet financiarisht nga Fondacioni OAK. Projekti u zbatua paralelisht në 3 shtete – Shqipëri, Moldavi dhe Serbi.

Projekti “Edhe Zërat Tanë” promovon qasjen pjesëmarrëse duke përfshirë fëmijët dhe të rinjtë në adresimin e dhunës seksuale ndaj fëmijëve në të gjithë Europën.



Pesë përfituese të D&E u zgjodhën për të qënë pjesë e projektit.

Gjatë muajve Janar – Mars 2019, grupi i përzgjedhur u trajnuar për të qënë “advokuese të reja” për dhunën seksuale. Gjatë programit të trajnimit 12 javor, të rejat advokuese morën informacion mbi deklaratën e të drejtave të fëmijëve; të drejtën e pjesëmarrjes, dhunën seksuale, advokacinë, lobimin, zgjodhën çështjen për të cilën do të advokonin dhe zhvilluan bashkarisht aktivitetet e fushatës së tyre.

Gjatë muajve Prill – Qershor 2019 advokueset e reja me mbështetjen e lehtësuesve materializuan aktivitetet e fushatës së tyre të advokimit. Aktivitetet advokuese u zhvilluan në përgjigje të problemeve të lidhura me dhunën seksuale që vetë advokueset kishin identifikuar në kontekstin e tyre lokal.

Në targetet të fushatës së advokimit u vendosën:

- Oficerët e kontaktit të parë në Drejtoritë Vendore të Policisë së Shtetit duke synuar përmirësimin e mënyrës sesi vikimat e dhunës seksuale trajtohen dhe më tej referohen në shërbimet e përshtatshme;
- Të rinjtë e moshës 15 – 16 vjeç;

Fushata e avdokimit u zhvillua gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2019, ndërkohë që përpara fillimit të fushatës materialet ndërgjegjësuere ishin gati, të tilla si:



Poster për oficerët e policisë



Broshurë informuese për oficerët e policisë & të rinjtë



Video ndërgjegjësuere për dhunën seksuale “Thyej Heshtjen”

Askush nuk mund të ndajë imazhe personale të personave të tjerë pa miratimin e tyre. Kjo është vepër penale dhe dënohet në bazë të ligjit.

Të dashur bashkëmoshatarë! Shmangni ndarjen e imazheve tuaja personale, edhe kur dikush mund t'ju kërkojë si shenjë dashurie apo besimil!



Falë lehtësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, advokueset dhe lehtësueset realizuan takime direkte me oficerë policie në 6 qarqe të Shqipërisë (Durrës, Shkodër, Lezhë, Tiranë, Berat dhe Kukës).

“Të qenit pjesë e këtij projekti ka ndryshuar tek unë jo vetëm mënyrën se si mendoj ose flas për dhunën seksuale, por edhe më mësoi shumë gjëra të reja që nuk i dija më parë, ose nuk i lidhja fare me dhunën seksuale.”

Ada, Advokuese

FUSHATA E ADVOKUESEVE E SHPREHUR NË SHIFRA

- ✓ **1** deklaratë zyrtare për Zv. Ministren e Brendshme/ Koordinatorën Kombëtare për Çështje të Luftës kundër Trafikimit në Persona duke tentuar të ngrenë çështje specifike që do të garantonin trajtimin profesional të viktimave të dhunës seksuale nga oficerët e policisë.
- ✓ **3** takime me zyratë të nivelit të lartë për të diskutuar për mënyrën e trajnimit të viktimave të dhunës seksuale nga oficerët e kontaktit të parë
- ✓ **69** oficerë policie në 6 rrethë të Shqipërisë morrën informacion si të përmirësonin qasjen ndaj viktimave të dhunës seksuale.
- ✓ **187** të rinj në 6 rrethë të Shqipërisë u bënë pjesë e sesioneve të informimit për dhunën seksuale.
- ✓ **80** individë u informuan mbi dhunën seksuale dhe mënyrat e raportimit gjatë aktivitetit ndërgjegjëses të 30 Korrikut 2019.
- ✓ **1** komunitet praktike u organizaun me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që kanë në fokus të tyre pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në ndryshimin e çështjeve/ problemeve që kanë rëndësi për ta.
- ✓ **45.000** views në median sociale të videos ndërgjegjësuere “Thyej heshtjen”.

AKTIVITETE NDËRGJEGJËSIMI MBI TRAFIKIMIN NË PERSONA

Organizimi i sesioneve informuese në shkolla

- Një fushatë e dedikuar sensibilizimi për çështje të trafikimit në persona është organizuar në kuadër të këtij muaji, i njohur ndryshe si muaji antitrafikim. Fushata u koordinua nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti-Trafik / Ministria e Brendshme.
- Nga D&E janë zhvilluar 30 sesione informimi në shkollat 9 – vjeçare dhe gjimnazet e qarkun e Tiranës, përfshirë edhe zonat në periferi të saj dhe Njësitë Administrative përreth si: Vora dhe Ndroqi. Sesionet e informimit në shkolla janë organizuar në bashkëpunim me Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Psikologët e këtyre shkollave.

775 nxënës u bënë pjesë e sesioneve të informimit

Aktivitete ndërgjegjësimi për të drejtat e viktimave të veprave penale

Gjatë vitit 2019, D&E ka organizuar 9 sesione informuese me pjesëmarrjen e 488 personave në Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Shkodër për të drejtat e viktimave të veprave penale, veçanërisht viktimat e trafikimit.

Në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë në Vlorë dhe Durrës janë zhvilluar dy sesione informimi me studentët, si dhe një sesion i tretë është zhvilluar më datë 31 maj me Tryezën Teknike të Komitetit Rajonal Antitrafik – Tiranë si më poshtë:



Gjatë muajit Qershor në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë Tiranë dhe Shkodër, si dhe Drejtorinë e Qytetit Studenti janë zhvilluar disa sesione informimi me studentët:



Më datë 14 qershor 2019, në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, u zhvillua sesioni i informimit me temë "Të drejtat e viktimave të veprës penale". Në këtë trajnim morën pjesë 65 studentë të profilit Bachelor dhe Master të Fakultetit të Drejtësisë.



Në Shkodër më datë 19 qershor 2019, në ambientet e Universitetit "Luigj Gurakuqi", u zhvillua sesioni i informimit me temë "Të drejtat e viktimave të veprës penale". Në këtë sesion morën pjesë rreth 80 studentë dhe drejtues të Fakultetit.



Ndërsa në Tiranë, në datat 20, 26 dhe 27 qershor dhe 03 Korrik 2019, në ambientet e Bibliotekës së Qytetit Studenti, u zhvilluan 4 sesione informimi me temë "Të drejtat e viktimave të veprës penale ku mori pjesë rreth 183 studentë dhe punonjës të administratës së Qytetit Studenti.

BASHKËRENDIME

Koordinime me aktorë të tjerë kundër trafikimit

- ❖ D&E ka marrë pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti –Trafik.
- Takimet e organizuara në kuadër të Mekanizmit Kombëtar të Referimit;
- Mbledhje të Autoritetit Përgjegjës në lidhje me diskutimin e rasteve të vështira;
- Takime në kuadër të ngritjes dhe funksionimit të Bordit Këshillimortë viktimave të trafikimit;
- ❖ Gjatë vitit 2019 D&E ka patur një bashkëpunim edhe me Kuvendin e Shqipërisë, në veçanti në kuadër të hartimit dhe miratimit të Strategjisë Kombëtare për Edukimin Ligjor të Publikut. D&E ka qenë pjesë e grupit të punës për hartimin e Strategjisë dhe pas miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë me Vendimin Nr. 47/2019, datë 18.4.2019 dhe është antare e Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut. *Strategjia Kombëtare për edukimin ligjor të publikut (SELP) është dokumenti I parë strategjik I miratuar në Shqipëri me fokus të veçantë edukimin ligjor të qytetarëve*
- ❖ Gjatë 2019 D&E ka marrë pjesë në të gjitha takimet e Komitetit Rajonal Antitrafik dhe Tryezat teknike të organizuara.

Rritje e kapaciteteve të profesionistëve

Organizata “Të Ndryshëm dhe Të Barabartë” në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar, ka organizuar 4 trajnimeve me profesionistë nga qarqe të ndryshme të Shqipërisë si: Kukës, Durrës, Korçë dhe Gjirokastrë, duke përfshirë: punonjës socialë, psikologë, staf të zyrave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, punonjës të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, administratorë social, etj. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte rritja e kapaciteteve të profesionistëve në lidhje me menaxhimin e rasteve të viktimave / viktimave të mundshme të trafikimit duke u fokusuar në të gjitha aspektet, nga identifikimi, referimi, mbrojtja deri në riintegrimin e tyre në shoqëri.



20 Qershor 2019 në Kukës me pjesëmarrjen e 27 anëtarëve të Komitetit Rajonal dhe Tryezës Teknike Antitrafikim Kukës, staf të zyrave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, PMP-ve, administratave sociale, nënprefektë, përfaqësues nga Këshilli i qarkut, zyrat e punës, inspektorati i Punës, organizata jofitimprurëse të qarkut, etj.



26 Qershor 2019 në Durrës me pjesëmarrjen 33 anëtarëve të Komitetit Rajonal dhe Tryezës Teknike Antitrafikim Durrës, PMP-ve, mjekë, specialistë të SLKTF dhe Drejtorisë së Migrationsit, nënprefektë, përfaqësues nga Këshilli i qarkut, Zyrat e Punës, Inspektorati i Punës, organizata jofitimprurëse të qarkut, vellektor i Komitetit të Përgjigjeve, etj.



03 Korrik 2019 në Korçë me pjesëmarrjen e 23 anëtarëve të Komitetit Rajonal dhe Tryezës Teknike Antitrafikim Durrës, Shërbimit Social Shtetëror, Drejtorisë Arsimore, PMP, specialistë të SLKTF dhe Drejtorisë së Migrationsit, administratave sociale, përfaqësues nga Këshilli i qarkut, Zyrat e Punës, Inspektorati i Punës, organizata jofitimprurëse të qarkut, etj.



04 Korrik 2019 në Gjirokastrë me pjesëmarrjen e 27 anëtarëve të Komitetit Rajonal dhe Tryezës Teknike Antitrafikim Durrës, Shërbimit Social Shtetëror, PMP, specialistë të SLKTF dhe Drejtorisë së Migrationsit, administratave sociale, nënprefektë, përfaqësues nga Këshilli i qarkut, Zyrat e Punës, Inspektorati i Punës, organizata jofitimprurëse të qarkut, etj.

Mbështetje për zhvillimin e kapaciteteve të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashkitë e përzgjedhura për të adresuar trafikimin e fëmijëve dhe shfrytëzimin për punë

Donator: Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Objektivi specifik i projektit ishte të rriste njohuritë praktike dhe aftësitë e Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve për të trajtuar (menaxhuar) rastet e trafikimit të fëmijëve.

Bashkitë ku u zbatua projekti: Tiranë, Elbasan, Vlorë, Fier, Durrës, Shkodër, Buqizë

Në kuadër të projektit janë organizuar takime nëbashkitë respektive me pjesëmarrjen e Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve, Drejtuesve të Shërbimit Social. ku është diskutuar në lidhje me Procedurat Standarte të Veprimit për Mbrojtjen e viktimave /viktimave të mundshme të trafikimit, çështje të identifikimit të VMT/VT, referimin dhe asistencën e ofruar.

Aktivitetet kryesore të projektit:

Hartimi i një manuali trajnimi të përshtatur për strukturat e mbrojtjes së fëmijëve - Manuali u realizua në konsultim edhe me stafin e OSBE dhe Agjensinë Shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. Ai përmban udhëzime të hollësishme për identifikimin dhe ndihmën e viktimave; politika dhe aktivitete në terren në nivelin lokal; vlerësimin e nevojave dhe adresimin e duhur; koordinimin ndërinstytucional, përfshirja e rolit të ekipeve multidisiplinore në nivelin lokal; menaxhimi i rasteve dhe shërbimet; këshillim dhe mbështetje psikologjike; rritje e aftësive për jetën dhe edukim profesional.

Trajnim në vendin e punës për punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve - Qëllimi i këtij aktiviteti ishte të ndihmonte punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve të adresonin çështjet të punës së përditshme në lidhje me menaxhimin e rasteve të fëmijëve viktimë të trafikimit ose shfrytëzimit. Nën lehtësimin e stafit të D&E u realizuan 9 sesione trajnimi në vendin e punës, me pjesëmarrjen e 25 punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve.



Supervizim klinik –25 punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve (PMF), si edhe operatorëve socialë të Bashkisë Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Elbasan ju ofrua mundësia të realizonin seanca individuale supervizimi me një psikolog klinik me përvojë.

Supervizimi klinik kishte qëllim të ndihmonte PMF të kuptonin më mirë vështirësitë me të cilat përballeshin në punën e tyre të përditshme, si edhe efektet që këto vështirësi mund tju sillnin në aspektin personal dhe profesional, si edhe të lehtësonin ngarkesën e tyre emocional.

Mbështetje për zonat e prekura nga tërmeti - në përgjigje të situatës së emergjencës të krijuar prej tërmetit të 26 Nëntorit 2019, me mbështetjen financiare të projektit D&E ndihmoi punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve në Bashkinë Durrës për të adresuar nevojat e fëmijëve dhe familjeve brenda qytetit të Durrësit, në zonën e Sukthit, Golemit, Kulle. Mbështetje u ofrua edhe për familje dhe fëmijë në Kodër Kamëz. D&E angazhoi një skuadër psikologësh dhe punonjesisht socialë për të plotësuar nevojave të fëmijëve dhe familjeve të zhvendosura dhe të prekura nga tërmetit përmes plotësimit të nevojave themelore dhe mbështetjes psiko-sociale.



Rezultatet e projektit:

Ndihma konsistoi në:

- Mbështetje psiko-sociale
- Mbështetje emergjente për strehim
- Adresimi i nevojave bazike për ushqim, veshje, materiale higjienike, materiale të kujdesit për fëmijët etj.
- Adresimi i nevojave specifike të fëmijëve me aftësi ndryshe;
- Seanca këshillimi individuale dhe në grup;
- Sesione psiko-edukimi me fëmijët në shkollë;
- Sesione art – terapi me fëmijët;
- Lojra dhe aktivitete të tjera argëtuese me fëmijët etj.

- Janë përmirësuar aftësitë dhe njohuritë e 25 punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve për të identifikuar rastet e trafikimit të fëmijëve bazuar në kornizën më të re ligjore për mbrojtjen e fëmijëve, Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe dispozitat e reja të Kodit Penal.
- Janë rritur njohuritë dhe aftësitë praktike të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve për të menaxhuar rastet e trafikimit të fëmijëve.
- Gjatë zbatimit të projektit 16 fëmijë viktimë trafikimi, janë asistuar dhe menaxhuar në mënyrë profesionale falë bashkëpunimit të PMF me menaxherëve të rastit të D&E.
- 25 punonjës të mbrojtjes së fëmijëve janë ndihmuar të përmirësojnë mirëqenien e tyre profesionale dhe të rrisin aftësitë për të reaguar ndaj efekteve të konsumimit profesional.
- Është përgatitur një manual për mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi dhe shfrytëzimi.
- Ofrimi i mbështetjes dhe shërbimeve për fëmijët dhe familjet e prekura nga tërmeti, si edhe profesionistët në bashkitë më të prekura.
- 496 fëmijë të prekur nga tërmeti janë mbështetur me aktivitete psiko-sociale, si rezultat i të cilave fëmijët manifestuan ulje të nivelit të ankthit, frikës dhe rritje të mekanizmave për të përballuar sfidat e jetës së përditshme.
- 109 familje të prekura nga tërmeti ju janë adresuar nevojat bazike dhe ju është ofruar mbështetje psiko-sociale.

TRAJNIME DHE PREZANTIME TË OFRUARA NGA D&E NË AKTIVITET NDËRKOMBËTARE

Prezantim në trajnimin *“Trafikimi në persona dhe ligji”*, organizuar nga rrjeti *“Renate”* në Suedi, Maj 2019.




Prezantim gjatë takimit të shkëmbimit të eksperiencave mes organizatave të rrjetit transnacional për integrimin në punë të grave viktima të trafikimit, organizuar më 13 Shtator 2019 nga organizata KMOP në Romë, Itali.

Në Konferencën e katërt Botërore të Strehëzave të Grave (4WCWS), organizuar nga *“Fondacioni Kopshti i Shpresës / Rrjeti Botëror i Strehëzave të Grave”* në Kaohsiung/ Taiëan, më 5 – 8 Nëntor 2019, D&E u ftua për të bërë prezantim mbi *“Konsiderimi dhe kujdesi i veçantë për fëmijët e të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore”*.



PUBLIKIME



► **Botime të realizuara në kuadër të projektit ‘Edhe Zërat tanë’**



Poster informues për oficerët e policisë



Broshurë informuese për oficerët e policisë



Broshurë informuese për të rinjtë



Video ndërgjegjësuese për dhunën seksuale “Thyej Heshtjen”

https://www.youtube.com/watch?v=OgEA550aUNY&feature=emb_logo

- ▶ **Botime të realizuara në kuadër të projektit “Të rrisim identifikimin proaktiv të viktimave / viktimave të mundshme të trafikimit në nivel lokal”**



Broshurë informuese për viktimat e mundshme të trafikimit/ viktimat e trafikimit

- **Materiale ndërgjegjësuese të realizuara në kuadër të projektit “Bashkëpunim ndërmjet OShC-ve dhe grupeve të ish-viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje për fuqizimin ekonomik të viktimave”**



Poster informues



T- Shirt me sloganin e fushatës



Adeziv informues



Baner për ndeshjet me FSHF



Baner për marshimin #METY



Stampat për futbollistët